
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA ZA OSOBLJE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr. 109./17	Data: 26.07.2017	

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Komuna e Istogut, Drejtorati për Administratë Komunale publikon këtë :

K O N K U R S

Vendi i punës: Roje Objekti

Numri i ekzekutuesve : 1 (një)

Vendi i punës : Objekti i Komunës

Koeficienti: 4

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Sigurimi i fizik i objektit të Komunës gjatë natës ,ditëve jo të punës si dhe festave shtetërore ;
2. Kryerja e punëve në bazë të kërkesave të Drejtorit të Drejtoratit;
3. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ;
4. Të njoftoi me kohë për problemet apo veshtirësitë në punë;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë për konkurim - punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë për kryerjen e detyrave të punës.

Kualifikimi i kërkuar:

- Përgaditja shkollore e mesme.

Aftësitë, pervoja dhe atributet tjera:

- Të ketë përvojë pune 2 (dy) vjeçare
- Aftësi psike-fizike,
- Aftësi komunikimi dhe
- Te jetë i ndërgjegjshëm ne punën qe benë.

Kohëzgjatja e punës-kontratës:

- Me kohë pacaktuar,

Puna provuese:

- 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentet e kërkuara:

- Dëshmia përkatëse për posedimin e diplomës së shkollës së mesme
- Dëshmi të përvojës së punës
- Dy rekomandime
- Letërnjoftimi
- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime

Konkursi mbetet i hapur: **15 ditë, nga dita e shpalljes** në mjetet e informimit.

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin formularet e kërkesave, çdo ditë pune, në Qendrën për Shërbime me Qytetar, zyra nr.100- kati i parë, në ndërtesën e Komunës.

Me kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të bëhet intervista nga Komisioni multietnik dhe i ballansuar gjinor, ndërsa për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Dokumentat e pakompletuara, si dhe parashtrimi i kërkesave pas skadimit të afatit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.



Udhëheqësi i Personelit
 Fatmir Bytyci